

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Konsultim
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Transpozim i Direktivës së BE-së
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Direktiva (BE) 2018/1808 që ndryshon direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë)  Direktiva (BE) 2018/1972 (Kodi i Komunikimeve Elektronike)
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Jo e zbatueshme
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	Për t’u plotësuar
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	.....2022
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMITë NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	.....
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	Emri, Mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit:
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)</b>	
<b>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</b> <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij. Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë</i>	
<p>Angazhimet e Shqipërisë në fushën e shoqërisë së informacionit, rrjedhin nga neni 70, “Mbi përafrimin e legjislacionit”, si dhe neni 103 “Shoqëria e Informacionit” të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafuar legjislacionin shqiptar</p>	

me legjislacionin e BE-së. Nenet 102-104 të MSA-së, parashikojnë detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së dhe harmonizimin me politikat e BE-së. Neni 102 i MSA, parashikon bashkëpunimin në fushën audio-vizuale. Kjo përfshin detyrimin e Shqipërisë që të harmonizojë politikat e saj në rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimit ndërkufitar me standardet dhe legjislacionin e BE-së.

Aktualisht Direktiva e BE-së 2018/1808, që ka amenduar direktivën 2010/13, “Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë”, nuk është adoptuar në legjislacionin shqiptar, ndërsa ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është tërësisht i përafruar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010.

Ndryshimet kryesore në Direktivën AVMS lidhen me përfshirjen në fushën e zbatimit të saj të platformave për shpërndarjen e videove, përcaktimin e detyrimeve të ofruesve të platformave të ndarjes së videove, rishikimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë (on demand service), rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizive për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, etj. Po ashtu, në këtë dokument gjejmë trajtim edhe një sërë çështjesh të tjera si nxitja e bashkërregullimit dhe e vetërregullimit përmes kodeve të sjelljes veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të miturve në komunikimet me natyrë tregtare, rregulla mbi rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, përfshihjen e konceptit të edukimit mediatik. Një vend i posaçëm në të, i kushtohet edhe sigurimit të aksesit në informacion të personave me nevoja të veçanta shqisore.

Ne ligjin nr. 97/2013, ne nenin 87 janë parashikuar detyrimet e mbartjes, duke transpozuar pjesërisht Direktivën e Shërbimit Universal 2002/22 EC (Article 31). Me direktivën 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian, janë miratuar disa ndryshime për “Must Carry Rules” dhe në këto kushte lind nevoja e rishikimit të nenit 87 të ligjit organik për mediat audiovizive, për të qenë në harmoni me direktivën 2018/1972.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme pasi, në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “*acquis communautaire*” është detyrim për Shqipërinë.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimitë*

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Të rritet transparenca e pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike;
- Të mbrohet dinjiteti, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre;
- Të nxitet vetë-rregullimi dhe bashkërregullimi si një plotësim i mekanizmave legjislativë, gjyqësorë dhe administrativë;
- T’u sigurohet akses në përmbajtjet audiovizive “personave me nevoja të veçanta”.
- Të garantohet e drejta e informimit dhe lirisë së shprehjes.

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit. Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

- Opsioni 0: Status Quo-ja (ska rregullim ligjor); nuk është opsion i preferuar për shkak të nevojës që del për rishikimin e parashikimeve të ligjit në fuqi për mediat audiovizive, kjo në linjë edhe me praktikën më të mira dhe modelin të BE-së për bërjen pjesë të ligjit të brendshëm të ndryshimeve të direktivës.
- Opsioni 1 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues, është tërësisht në përputhje me direktivën 2010/13, edhe ndryshimet që ka pësuar kjo direktivë, me Direktivën 2018/1808, vlerësohet të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues. Gjithashtu, edhe nga eksperiencat e studiuara në një pjesë të mirë të vendeve të Bashkimit Evropian, është vënë re ndërhyrje (amendamente) në ligjet organike të shërbimeve mediatike audiovizive.
- Opsioni 2: Miratimi i një ligji të ri. Ky nuk është një opsion i preferuar, duke qenë se ndryshimet prekin disa prej dispozitave të ligjit në fuqi e më e përshtatshme është ndërhyrja në ligj. Kjo, shkon në linjë edhe me ndryshimet e vetë direktivës, për sa kohë nuk ka një direktivë që shfuqizon direktivën 2010/13, por e amendon atë.

### **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar. Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.*

**Opsioni i preferuar** nuk shoqërohet me ndikim ekonomik për Buxhetin e Shtetit, pasi AMA është organ publik i pavarur që nuk financohet nga Buxheti i Shtetit.

Miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, do të japë kontribut në garantimin e mëtejshëm të lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit.

Ndryshimet lidhur me komunikimet me natyrë tregtare, pritet të sjellin efekte pozitive për subjektet e fushës audio/audiovizive, duke qenë se u krijohet mundësia për fleksibilitet në ndarjen e fashave të komunikimeve me natyrë tregtare, që do të mund të pasohet dhe me përfitime të natyrës financiare.

Në projektligj përfshihet vetërregullimi dhe bashkërregullimi, të cilat do të gjejnë zbatim përmes hartimit të kodeve të sjelljes të hartuara dhe dakordësuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike, mbrojtje më e mirë për fëmijët, përfshirë edhe të dhënat personale të tyre, etj

Rishikimi i rregullave për transparencën e pronësisë, promovimit të veprave evropiane në shërbimet mediatike me kërkesë (on demand service), përfshirja e garantimit të aksesit në informacion të personave me aftësi të veçanta, përfshirja e edukimit mediatik janë masa të cilat pritet të ndikojnë drejtpërdrejt në lirinë e shprehjes dhe të drejtës së informimit si të drejta kushtetuese.

Vendosja e detyrimit të mbartjes (must carry) për programet me interes për publikun ka si qëllim garantimin e aksesit në transmetimet e shërbimeve publike dhe ofrimin për publikun të një larmishmërie programesh.

### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.*

**Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Jo e aplikueshme	Jo e aplikueshme	Jo e aplikueshme

### **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse)*

Projektligji është hartuar me kontributin e Autoritetit të Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjitikën, në kuadër të grupit ndërinstitucional të punës për integrimin Evropian për Kapitullin 10, “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

Projektligji, Raporti Vlerësimit të Ndikimit dhe Relacioni Shpjegues do të konsultohen gjerësisht me institucionet publike dhe grupet e interesit përmes procedurës së konsultimit publik edhe në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit.

### **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohet zbatimi dhe monitorimi*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e opsionit të preferuar janë:

Autoriteti i Mediave Audiovizive, do të jetë autoriteti përgjegjës për zbatimin e detyrimeve sipas këtij ligji.

AMA, është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

- *Jepni kontekstin e politikës*

Kuadri ligjor ekzistues që rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre është ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën

e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ky ligj është përafuar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë).

Në fushën e politikës audiovizuale, pjesa kryesore legislative është Direktiva 2010/13/BE, për shërbimet audiovizive, që mbulon transmetimet audiovizive tradicionale dhe shërbimet mediatike audio-vizuale me kërkesë dhe vendos një sërë rregullash minimale për të dy llojet e shërbimeve. Më datë 14 nëntor 2018, Këshilli i BE-së, ka miratuar ndryshimet në Direktivën 2010/13/BE me Direktivën 2018/1808/EU, “*Mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive), në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut*”.

Ky projektligj hartohet edhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 91, datë 09 shkurt 2022, “Për miratimin e Plani Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024,” në të cilin është parashikuar transpozimi i pjesshëm i Direktivës 2018/1808/BE.

Po ashtu, transpozimi i direktivës 2018/1972/BE, datë 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian, ku janë miratuar disa ndryshime për “Must Carry Rules” propozohet të bëhet njëkohësisht, pasi në VKM e sipërcituar është përfshirë detyrimi për transpozimin e kësaj direktive.

### **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Projektligji propozohet në përmbushje të angazhimeve të shtetit shqiptar që synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian, konkretisht përaftrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire*.

Ligji nr. 97/2013 është kuadri ligjor bazë që normon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive. Direktiva e BE-së 2018/1808, që ka amenduar direktivën 2010/13, “Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë”, nuk është adoptuar në legjislacionin shqiptar. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është tërësisht i përafuar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010.

Ndryshimet kryesore të propozuara në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar kanë si qëllim përcaktimin e rregullave të reja ose rishikimin e rregullimeve mbi vetërregullimin dhe

bashkërregullimin; rishikimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve me kërkesë (VOD; rishikimin e rregullave për transmetuesit audioviziv, etj.

Në direktivën 2018/1808 përcaktohet që duhet të ketë më shumë transparencë lidhur me pronësinë e ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv (OSHMA).

Direktiva ka forcuar detyrimin e OSHMA-ve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut. Në të parashikohet se vendet do të marrin masat e duhura për të siguruar që shërbimet e medias audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të medias nën juridiksionin e tyre, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve do të vihen në dispozicion vetëm në atë mënyrë që siguron se të miturit normalisht nuk do t'i dëgjojnë ose shohin ato. Këto masa mund të përfshijnë përzgjedhjen e kohës së transmetimit, mjetet e verifikimit të moshës ose masa të tjera teknike. Ato duhet të jenë në proporcion të drejtë me dëmin e mundshëm të programit. Përmbajtjet më të dëmshme, siç është dhuna dhe pornografia, do t'i nënshtrohen masave më të rrepta.

Të dhënat personale të fëmijëve të mbledhura apo të nxjerra nga OSHMA-të, nuk do të përpunohen për qëllime tregtare, të tilla si psh marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi etj.

Edhe për personat me aftësi të kufizuara, (nevoja të veçanta) janë zgjeruar dhe rritur kërkesat për OSHMA-të, duke shtuar detyrimin e tyre që në mënyrë progresive t'i bëjnë shërbimet e tyre më të arritshme për këtë kategori personash përmes masave propocionale.

Po ashtu, në këtë dokument gjejnë trajtim edhe një sërë çështjesh të tjera si nxitja e bashkërregullimit dhe e vetërregullimit përmes kodeve të sjelljes duke përfshirë edhe kodet në lidhje me mbrojtjen e të miturve kundrejt komunikimeve tregtare.

Një tjetër aspekt i trajtuar në direktivë është edhe edukimi mediatic, me të cilin kuptohet aftësia, njohuria dhe të kuptuarit që u lejon individëve të përdorin në mënyrë të sigurt dhe efektive, përmbajtjet e shërbimeve mediatike audiovizive. Aktualisht nuk ka një parashikim mbi edukimin mediatic në ligjin aktual dhe promovimi i edukimit mediatic është parashikuar si një nga funksionet e autoritetit rregullator.

Me direktivën 2018/1972/BE, e datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian, janë miratuar disa ndryshime për “Must Carry Rules” dhe lind nevoja e rishikimit të nenit 87 të ligjit për të qenë në harmoni me direktivën 2018/1972. Vendosija e detyrimit të mbartjes (must carry) ka si qëllim garantimin e aksesit në transmetimet e shërbimeve publike dhe ofrimin për publikun të një larmishmërie programesh që konsiderohen me interes të lartë për publikun, sidomos nga shikuesit e zonave më të largëta që nuk kanë mënyra të tjera për marrjen e informacionit, si dhe nga personat me aftësi të kufizuara.

Grupet e prekura nga ndryshimet e propozuara janë ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive të cilët do të ngarkohen me detyrimin për respektimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore, duke qenë se fushëzbatimi i kësaj nisme ligjore janë subjektet që ushtrojnë aktivitet audio dhe audiovizive mbështetur në rrjetet e komunikimeve elektronike.

Ndryshimet ligjore do të sjellin impakt edhe tek qytetarët, fëmijët apo personat me aftësi ndryshe, pasi ndryshimet e propozuara synojnë garantimin e të drejtave të tyre nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive, apo të komunikimeve tregtare të papërshtatshme, rritje të qasjes në informacion të personave me aftësi ndryshe.

## Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme pasi, në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, harmonizimi i legjislationit të fushës audiovizive me “*acquis communautaire*”, përfshirë edhe Direktivën 2018/1808 (EU) është detyrim për Shqipërinë.

Projektligji synon që në zbatim të direktivës 2018/1808 të plotësojë kuadrin ligjor me:

- Instrumentet e vetërregullimit dhe bashkërregullimit, si iniciativa në funksion të lirisë së shprehjes dhe informimit;
- Transparençën e pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike. Transparenca e pronësisë së mediave ka rëndësi jetike për sigurimin e pluralitetit në tregun mediatik dhe shmangjen e monopoleve dhe të përqendrimit. Transparenca, e parë si një ndër parimet për garantimin e pavarësisë editoriale, përfshin: dhënien e informacioneve me karakter financiar autoriteteve përkatëse dhe informimin e publikut si përdorues të shërbimeve audio/audiovizive, për t’u informuar lidhur me subjektet që përcaktojnë kontentin e këtyre shërbimeve;
- Masat e duhura për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojë zhvillimin fizik, mendor apo moral të të miturve, përfshirë edhe reklamën për produktet të dëmshme ushqimore;
- Sigurimin e aksesit të përmbajtjeve audiovizive nga "personat me aftësi të veçanta";
- Fleksibilitetin mbi oraret e transmetimit të reklamave në mënyrë që të maksimizojnë kërkesat e reklamuesve;
- Ndalimet e aplikueshme për komunikimet me natyrë tregtare në lidhje me cigaret elektronike etj;
- Rishikimin e rregullave për “must carry rules”.

## Objektivi i politikës

- Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.
- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.

Qëllimi i nismës ligjore është përafrimi i legjislationit kombëtar me kuadrin ligjor të BE.

Objektivat specifike të propozimit janë:

- Të rritet transparenca e pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike;
- Të mbrohet dinjiteti, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, vecanërisht të fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre;
- Të nxitet vetë-rregullimi dhe bashkërregullimi;
- T’u sigurohet akses në përmbajtjet audiovizive “personave me nevoja të veçanta”.

## **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

## **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
  - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

- Opsioni 0: Status Quo-ja (ska rregullim ligjor); nuk është opsion i preferuar për shkak të nevojës që del për rishikimin e parashikimeve të ligjit në fuqi për mediat audiovizive, sipas praktikave të mira dhe modelit të BE-së për bërjen pjesë të ligjit të brendshëm të ndryshimeve të direktivës.
- Opsioni 1 (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues, është tërësisht në përputhje me direktivën 2010/13, edhe ndryshimet që ka



pësuar kjo direktivë, me Direktivën 2018/1808, vlerësohet të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues. Gjithashtu, edhe nga eksperiencat e studiuara në një pjesë të mirë të vendeve të Bashkimit Evropian, është vënë re ndërhyrje (amendamente) në ligjet organike të shërbimeve mediatike audiovizive.

- Opsioni 2: Miratimi i një ligji të ri. Ky nuk është një opsion i preferuar, duke qenë se ndryshimet prekin disa prej dispozitave të ligjit në fuqi e më e përshtatshme është ndërhyrja në ligj. Kjo, shkon në linjë edhe me ndryshimet e vetë direktivës, për sa kohë nuk ka një direktivë që shfuqizon direktivën 2010/13, por e amendon atë.

Palët e prekura prej opsionit të preferuar, janë ofruesit e shërbimeve mediatike audio/audiovizive, çdo individ, si dhe AMA.

**Opsioni i preferuar** nuk shoqërohet me ndikim ekonomik, (kosto), për Buxhetin e Shtetit, pasi AMA është organ publik i pavarur që nuk financohet nga Buxheti i Shtetit.

Propozimi i politikave do të sjellë ndikim të drejtpërdrejtë për subjektet (OSHMA) të karakterit financiar, si rezultat i ndryshime të propozuara lidhur me: marrjen e masave teknike për mbrotjeje të mituve; sigurimin e aksesit në programet audiovizive të personave me aftësi të vecanta; kontributet financiare me të cilat mund të ngarkohen subjektet që forojne shërbime audiovizive me kërkesese (on demand service).

Projekti nuk pritet të shoqërohet me efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

AMA, është institucion i pavarur që financohet nga burimet e veta dhe nuk përfiton fonde nga buxheti i shtetit ndaj dhe efektet financiare i merr përsipër t'i mbulojë nga të ardhurat e veta.

## Komuniteti

Propozimi pritet të sjellë sidomos **ndikime sociale**: rregullimi i peizazhit mediatik, rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit lidhur me kontentin e transmetuar nga OSHMAve, forcimin e masave mbrotjeje të fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive garantimi i të drejtave të tyre në komunikimet tregtare, mbrotjen e të dhënave të tyre personale dhe garantimin e të drejtës kushtetuese për informim edhe të personave me nevoja të vecanta

Mediat luajnë rol etik në gjenerimin e kulturës demokratike, dhe propozimet ligjore kanë si qëllim që t'i ofrojnë publikut një përmbajtje sa më cilësore.

## Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues, është tërësisht në përputhje me direktivën 2010/13, edhe ndryshimet që ka pësuar kjo direktivë, me Direktivën 2018/1808, vlerësohet të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues.

## Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Struktura e ngarkuar për zbatimin e opsionit të preferuar është Autoriteti i Mediave Audiovizive

Disa nga pengesat e mundshme në zbatimin e ndryshimeve lidhen me bërjen efektive dhe të zbatueshme të instrumenteve të vetërregullimit dhe bashkërregullimit, modele për të cilat, në vendin tonë mungon eksperiencia.

Pengesë tjetër ka gjasa të jenë mugesat e burimeve njerëzore (interpretet) dhe kostot financiare që mund të kenë OSHMA për të përmbushur detyrimin ligjor për aksesin në informacion nga personat me aftësi të veçanta.

## Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Duke qenë se ndryshimet e propozuar lidhen me përmbajtjet programore, Autoriteti i Mediave Audiovizive bazuar në kompetencat e ligjit do të vijojë të monitorojë tërësinë e programeve të transmetuara nga OSHMA-të. AMA do të kontrollojë përmbushjen nga OSHMA-të të kërkesave lidhur me garantimin e të drejtave dhe lirive themelore në transmetimet audiovizive, garantimin e konkurrencës së ndershme, mbrojtjen e konsumatorëve, aksesueshmërinë e personave me nevojë të veçanta. Sa i përket vetë/bashkërregullimit, vlerësimi i përmbushjes së tyre do të matet nga Kodet e Sjelljes të dakordësuara nga ose me grupet e interesit.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>										
Kosto për buxhetin –										

një herë											
Kosto për buxhetin – në vazhdim											
Kosto për biznesin – një herë											
Kosto për biznesin – në vazhdim											
Kosto për grupet e tjera – një herë											
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim											
<b>Kosto në total</b>											
<b>Kosto e zbritur në total</b> = Kosto në total x faktorin zbritës											
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim											
Përfitimi për biznesin – një herë											
Përfitimi për biznesin – në vazhdim											
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë											
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim											
Kosto për buxhetin – në vazhdim											
<b>Përfitimi në total</b>											
<b>Përfitimi i zbritur në total</b> = Përfitimi në total x faktorin zbritës											
<b>Vlera aktuale e kostos në total</b>											
<b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>											
<b>Vlera aktuale neto (VAN)</b> = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total											

### Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			